



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. .... Prot.

Vlorë, më 20.02.2017

**Vendim**  
**Nr. 28, datë 20.02.2017**

**PËR**  
**MIRATIMIN E PROCEDURËS SË HARTIMIT DHE MIRATIMIT TË LISTËS**  
**SË KANDIDATURAVE PËR ADMINISTRATOR TË INSTITUCIONIT.**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 51 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Senati Akademik,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë procedurën e miratimit të listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret për Administrator të Institucionit si më poshtë:
  - a. Ngritjen e një Komisioni ad hoc për vlerësimin e përputhshmërisë së dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët për administrator të institucionit me kriteret bazë që parashikon pika 4 e nenit 51 të Ligjit Nr. 80/2015.
  - b. Kriteret preferenciale që BA ka sugjeruar në njoftimin publik për procedurën e konkurimit të hapur për administrator, vlerësohen prej tij.
  - c. Komisioni i mësipërm të ketë në përbërje 3 (tre) anëtarë të propozuar e miratuar nga Senati, njëri prej të cilëve të jetë i fushës juridike.
  - d. Komisioni ad hoc harton projekt-vendimin e listës së kandidatëve që plotësojnë kriteret bazë që parashikon pika 4 e nenit 51 të Ligjit Nr. 80/2015 dhe listën e kandidatëve që nuk i plotësojnë ato së bashku me arsyetimet përkatëse.
  - e. Projekt vendimi diskutohet nga anëtarët e senatit dhe miratohet me votim të hapur.
  - f. Vendimi i miratuar i përcillet Bordit të Administrimit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**  
**Prof. Dr. Roland ZISI**

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.